**AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

# PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT
# (SKEMA E VLERËSIMIT)

Kjo është një skemë vlerësimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje.

## PJESA I

| | | |
|---|---|---|
| **Pyetja 1** | **C** | **1 pikë** |
| **Pyetja 2** | **C** | **1 pikë** |
| **Pyetja 3** | **B** | **1 pikë** |
| **Pyetja 4** | **A** | **1 pikë** |

## Pyetja 5 4 pikë

**Model përgjigjeje**
Përgjigjja e dhënë duhet të përqendrohet në të paktën dy nga momentet e mëposhtme bashkë me ilustrimet përkatëse (më shumë se një):

• Familja e autorit e vlerësonte rrëfimin e historive.
• Në një familje të madhe, rrëfimi i historive ishte një mundësi për të tërhequr vëmendjen.
• Leximi respektohej shumë në shtëpinë e autorit.
• Familja e tij e vlerësonte shumë arsimin.

| | |
|---|---|
| **4 pikë** | Përgjigjja jep një përshkrim ***të plotë*** për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Ajo përmban detajet e duhura për ilustrim, të marra nga fragmenti. |
| **3 pikë** | Përgjigjja jep një përshkrim për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Ajo përmban një detaj për ilustrim, të marrë nga fragmenti. |
| **2 pikë** | Përgjigjja jep një përshkrim ***të pjesshëm*** për mënyrën se si fëmijëria e autorit ndikoi në vendimet e tij për t'u bërë shkrimtar. Përgjigjja përmban një detaj ose asnjë nga pjesa për ilustrim. |
| **1 pikë** | Përgjigjja është ***minimale*** ose ***e pamjaftueshme.*** |
| **0 pikë** | Përgjigjja është e plotësisht e pasaktë. |

| | | |
|---|---|---|
| **Pyetja 6** | **C** | **1 pikë** |
| **Pyetja 7** | **B** | **1 pikë** |
| **Pyetja 8** | **B** | **1 pikë** |
| **Pyetja 9** | **D** | **1 pikë** |
| **Pyetja 10** | **D** | **1 pikë** |

## Pyetja 11 1 pikë

**Model përgjigjeje**

Kontrasti në paragrafin e parë ka në bazën e vet nga njëra anë kushtet e këqija atmosferike që përshkruhen në përrallë dhe, nga ana tjetër, kushtet në të cilat ndodhet djali.

- Në historinë që tregon Izabela, bën ftohtë - djali ndodhet nën hijen e një peme në një ditë plot diell.

**1 pikë** Nëse identifikon kontrastin mbi të cilin është ndërtuar paragrafi I.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

***Shënim:***

***Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.***

## Pyetja 12 (A) 2 pikë

**Model përgjigjeje**

Djali është një natyrë shumë e ndjeshme, emocionale. Ai e përjeton shumë historinë që i rrëfen vajza.

Kjo duket:
- Kur ngashërehet,
- Kur preket, kur vihet në merak,
- Kur i dalin lot në fund të historisë.

**1 pikë** Nëse përcakton natyrën e djalit.

**DHE**

**1 pikë** Nëse tregon me fjalët e veta ose shembuj nga fragmenti se ku shfaqet kjo natyrë e tij.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

## Pyetja 12 (B) 2 pikë

**Model përgjigjeje**
Djali ka një imagjinatë të zhvilluar dhe kjo shfaqet në dy momente:

- Kur Izabela i duket si vajza e përrallës, krejt e bardhë, mes borës dhe ai hidhet t'i shkojë në ndihmë.
- Kur e shikon Izabelën të ngrihet lart në ajër, mbajtur përdore nga gjyshja e saj.

**1 pikë** Nëse identifikon momentin e parë kur imagjinata e djalit shfaqet shumë e dukshme.

**DHE**

**1 pikë** Nëse identifikon momentin e dytë kur imagjinata e djalit shfaqet shumë e dukshme.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

## Pyetja 12 (C) 1 pikë

**Model përgjigjeje**

Izabela qesh,

**OSE**
E vë në lojë,

**OSE**
I thotë se është budalla.

**1 pikë** Nëse tregon si reagon Izabela.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

## Pyetja 13 (A) 3 pikë

**Model përgjigjeje**

- Izabela është një interpretuese shumë e mirë. Ajo ia përshtat gjestet dhe mimikën momentit të historisë që po tregon. Në momentin kur historia është e trishtuar, zëri i saj i krijon djalit të vogël pikërisht këtë përshtypje.

- Është pikërisht Izabela ajo që, me mënyrën e interpretimit, bën që djali të përfshihet emocionalisht në ngjarje. Prandaj ajo është një interpretuese shumë e mirë.

Psh:

- shpesh zëri i saj bëhet *therrës nga zemërimi ose shpreh gëzim,*
- u bënte një përshkrim të arrirë këtyre përfytyrimeve të mrekullueshme,
- u mëshoi me një ton të ngadaltë,
- mezi i doli zëri për të vijuar,
- e kishte marrë me mjaft seriozitet dhe lexonte me këmbëngulje,
- herë zë të ftohtë e monoton si bora që binte, herë zë lakmues e të ngrohtë,

**OSE**

- Izabela është një interpretuese e zonja, por edhe një vajzë e ndjeshme, pasi, sado të përpiqesh të interpretosh bukur, nuk mund t'ia arrish kësaj nëse nuk e ke kuptuar pjesën, nuk e ke ndjerë atë. Nuk ka mundësi që emocionet e saj, kur gëzohet apo hidhërohet, të jenë vetëm për shkak të interpretimit.

**Ilustrim:**

Izabela u mëshoi me një ton të ngadaltë, me një dhembshuri që ia dridhte, ia mbyste zërin dhe, kur ajo tha: "*vdekur, vdekur nga të ftohtët, natën e fundit të vitit*", nuk kishte si të vijonte më tej dhe **<u>lot të sumbullt</u>** i rrodhën përgjatë faqeve të zbehta.

**2 pikë** Përgjigjja shpreh pozicionin e nxënësit nëse mendon se Izabela është një interpretuese apo vajzë e ndjeshme.

**DHE**

**1 pikë** Ilustrimi me detaje për të mbështetur pozicionin e marrë.

**OSE**

**1 pikë** Nëse nxënësi shpreh një pozicion të caktuar, por nuk e mbështet me detaje.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

## Pyetja 13 (B) 2 pikë

**Model përgjigjeje**

**Mendimi i nxënësit është i pavarur.**

- Vajza më duket paragjykuese.

Nuk jam dakord me fjalët që ajo thotë, pasi si djemtë edhe vajzat ndikohen nga historitë e trishtuara. Emocionet janë për të gjithë njerëzit dhe s'më duket e drejtë që një djalë të mbetet i pandjeshëm.

**OSE**

- Vajza më duket e nxituar në mendimin e saj.

Nuk ka pse mendon se lotët janë vetëm për vajzat, pasi nuk ka asgjë të keqe nëse djemtë preken. Histori të tilla nuk janë vetëm për vajza.

**OSE**

- Vajza nuk gjykon drejt.

Këto janë stereotipa që ndajnë në mënyrë të padrejtë djemtë dhe vajzat. Nëse diçka është e bukur, e trishtuar, e dhimbshme apo tragjike, kjo mund të provohet në mënyrë personale nga kushdo, qoftë djalë apo vajzë.

**OSE**

- Vajza mendon gabim.

Emocionet janë një çështje personale. Varet nga tipi i njeriut dhe jo nga fakti se je djalë apo vajzë. Ka shumë vajza që nuk qajnë dhe kjo s'do të thotë asgjë, sikurse ka djem të ndjeshëm që emocionohen menjëherë. S'kemi pse i paragjykojmë.

**OSE**

- Vajza mendon drejt.

Në fund të fundit, është një përrallë dhe s'ka arsye pse ta përjetojë aq shumë dhe ta marrë aq seriozisht. Dihet se përrallat nuk janë të vërteta.

**OSE**

- Vajza mendon drejt.

Djemtë janë natyra të forta dhe s'kanë pse qajnë.

**1 pikë** Nëse shkruan se çfarë mendon në lidhje me fjalët e vajzës.
**DHE**
**1 pikë** Nëse shpjegon në është dakord ose jo me fjalët e saj.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

***Shënim:***

***Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.***

## Pyetja 13 (C) 1 pikë

- Edhe pse është një përrallë, më erdhi keq për fatin e vajzës.
- S'ka rëndësi nëse jam djalë apo jo. Edhe një djalë mund të preket nga histori të tilla.
- S'është turp që një djalë të përlotet.
- Historia ishte aq e bukur, sa për një çast e mendova si të vërtetë.
- Ti e tregove kaq bukur, sa më bërë të prekem.

- Etj

**1 pikë** Nëse imagjinon se çfarë mund të ketë thënë djali për të mbrojtur veten e tij.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

***Shënim:***

***Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përafrohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.***

---

## Pyetja 13 (D) 1 pikë

Fjalët ose fjalitë që janë me shkronja të pjerrëta dhe të vendosura mes thonjëzash, janë të marra nga përralla. Ato janë të tilla për t'i dalluar nga pjesa tjetër e tregimit.

**OSE**
Këto janë fjalë ose fjali të shkëputura nga përralla.

**1 pikë** Nëse shpjegon pse këto fjalë ose fjali janë me shkronja të pjerrëta dhe të futura mes thonjëzash.

**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

---

**Pyetja 14** **C** **1 pikë**

**Pyetja 15** **A** **1 pikë**

**Pyetja 16** **B** **1 pikë**

**Pyetja 17** **2 pikë**

**1 pikë** **mbiemri**: krejt të bardhë

**1 pikë** **shkalla:** sipërore

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Pyetja 18** | **2 pikë** | | |
| **1 pikë** | **fjala e përngjitur:** | mirëpo | |
| **1 pikë** | **klasa:** | lidhëz | |
| **Pyetja 19** | **2 pikë** | | |
| **1 pikë** | **atëherë:** | ndajfolje (kohe) | |
| **1 pikë** | **atmosferike:** | mbiemër | |
| **Pyetja 20** | **1 pikë** | | |
| **1 pikë** | **përemri:** | i pacaktuar | |
| **Pyetja 21** | **1 pikë** | | |
| **1 pikë** | **Kryefjala** | këto vezullime (gr- emëror) | |
| **Pyetja 22** | **1 pikë** | | |
| **1 pikë** | **kallëzuesi i përbërë:** | zuri të fliste | |
| **Pyetja 23 (a)** | **2 pikë** | | |
| | **rrethanorë:** | | |
| **1 pikë** | **midis borës** | **Lloji:** rr. vendi | **1 pikë** |
| **1 pikë** | **lehtë** | **Lloji:** rr. mënyre | **1 pikë** |

***Nxënësi mjafton të gjejë një rrethanor dhe llojin e tij. Ai do të marrë një pikë për rrethanorin e gjetur saktë dhe një pikë për përcaktimin e llojit të tij.***

| | | |
|---|---|---|
| **Pyetja 23 (B)** | **2 pikë** | |
| **1 pikë** | **mënyra**: | lidhore |
| **1 pikë** | **koha**: | e pakryer |

| | | |
|---|---|---|
| **Pyetja 24 (a)** | **B** | **1 pikë** |
| **Pyetja 24 (b)** | | **1 pikë** |
| **1 pikë** | | **Lloji:** mënyrore |

## Pyetja 25 6 pikë

Në vlerësimin e rubrikës *të shkruajmë* duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pyetjes, do të marrin pikët e plota për ***shtjellimin e idesë***. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë pyetjes, do të marrin pikë për ***stilin*** dhe ***saktësinë drejtshkrimore***, por nuk do të vlerësohen për ***shtjellimin e idesë***.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që ju i gjykoni si të rënda.

## Kriteret e vlerësimit

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shpjegon se si ndikojnë fjalët në jetën tonë;
- shprehet qartë, përmes detajeve dhe shprehjeve të përzgjedhura, për ndikimet që ka pasur;
- përdor ilustrime mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: STRUKTURA 1 pikë**

- respekton elementet e një eseje:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

***Nxënësi merr 1 pikë nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.***

***Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.***

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 1 pikë**

- krijon, përmes gjuhës që përdor, një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë**

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- ka saktësi drejtshkrimore.